

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI  
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“PRO BONO” SHPK**

Në bazë të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, si dhe të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” i ndryshuar, me vullnetin e tij të lirë, ortaku i vetëm i shoqërisë hartoi këtë Akt Themelimi dhe Statut të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) “**PRO BONO**” në datë 08/03/2024, e cila do të veprojë sipas legjislacionit në fuqi, e themeluar nga ortaku i saj i vetëm, si vijon:

**KAPITULLI I  
FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

**Neni 1  
Forma**

1. Shoqëria “**PRO BONO**” SHPK, (në vijim “Shoqëria”) krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Akti që përbën Aktin e Themelimit dhe Statutin njëkohësisht.
2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
3. Ky akt është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në të, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

**Neni 2  
Emërtimi**

1. Emërtimi i shoqërisë tregtare të themeluar nga ortaku i saj, do të jetë “**PRO BONO**” SHPK.

**Neni 3  
Objekti i veprimtarisë së shoqërisë**

1. Objekti i shoqërisë është si vijon:
  - a) Konsulence juridike në fushën civile, administrative, penale, tregtare, tatimor, doganore etj...;
  - b) Përfaqësim pranë gjykatave të të gjitha niveleve në Republikën e Shqipërisë apo jashtë saj; hartimin e kërkesë padive, kërkesave apo çfarëdo akti tjetër ligjor për subjekte fizik dhe juridik;
  - c) Përfaqësim pranë institucioneve publike dhe private, përgatitjen e çdo dokumentacioni apo akti, ndjekjen e procedurave administrative apo çdo kërkesë tjetër ligjore, në funksion të aktivitetit të të përfaqësuarit;
  - ç) Konsulence në fushën financiare dhe fiskale;



d) Dhënia e shërbimeve financiare dhe fiskale, hartimin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare, deklarin e punonjësve, përgatitjen e listëpagesave apo çdo akti tjetër ligjor në funksion të veprimitarisë së shoqërive tregtare dhe personave fizik;

e) Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar, si dhe mund të kryejë çdo aktivitet tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj;

#### **Neni 4**

##### **Selia**

1. Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga "Faruk S. Begolli, Nd. 26, Sh. 5, K. 6, Ap. 38, Njësia Bashkiake Nr. 4, Tiranë".

2. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si edhe jashtë saj.

#### **Neni 5**

##### **Kohëzgjatja e veprimitarisë**

1. Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar.

### **KAPITULLI II**

### **KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTAT**

#### **Neni 6**

##### **Kapitali themeltar**

1. Kapitali i shoqërisë do të jetë 10.000 lekë, si më poshtë:

- Ortaku i vetëm Znj. Lorena RRAPAJ.

#### **Neni 7**


##### **Kuotat dhe kalimi i tyre**

1. Kuota e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar mund të zotërohet nga një ose më shumë persona. Në rastin kur një kuotë e kapitalit të shoqërisë zotërohet nga më shumë se një person, në marrëdhënie me shoqërinë këta persona trajtohen si një ortak dhe të drejtat e tyre ushtrohen, nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët. Këta persona përgjigjen personalisht dhe në mënyrë solidare për detyrimet që lindin nga zotërimi i kuotës.

#### **Neni 8**

##### **Mënyra e fitimit dhe e kalimit të kuotave**

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin



prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shitblerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

2. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së cmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

3. Në rast kalimi të kuotave për persona të tretë që janë jashtë shoqërisë, ortaku që shet kuotat duhet të njoftojë me shkrim shoqërinë dhe duhet të ofrojë të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo ortakëve të tjerë të shoqërisë. Në rast se shoqëria nuk ka bërë të ditur vendimin e saj brenda tre muajve nga data e njoftimit të fundit sipas paragrafit të mësipërm, miratimi i transferimit konsiderohet i dhënë. Në rast se shoqëria refuzon të japë miratimin e transferimit, ortakët brenda tre muajve nga data e këtij refuzimi duhet të blejnë ao të lejojnë blerjen e kuotave të kapitalit themeltar me vlerën kontabile të kapitaleve të veta që do të rezultojë sipas bilancit kontabël në datën e shitjes së kuotave.

### **KAPITULLI III ASAMBLEJA DHE ADMINISTRATORI**


#### **Neni 9**

#### **Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj**

1. Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
2. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - d) emërimin dhe shkarkimin e administratorit/ve, si dhe përcaktimin e shpërblimit të tij;
  - e) riorganizimin dhe mbylljen e shoqërisë;
  - f) çështje të tjera të parashikuara nga ligji për shoqëritë tregtare.

#### **Neni 10**

#### **E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës**



1. Çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut. Bashkëzotëruesit e një kuote ushtrojnë të drejtat bashkërisht, sipas nenit 72 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
2. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme në bazë të një autorizimi, nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
3. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
4. Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 11**

#### **Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme**

1. Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, ose sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë me kërkesë të ortakut.
2. Ajo mbledhet në rastet e përcaktuara në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe thirret edhe sipas mënyrë të përcaktuar në këtë ligjit.

#### **Neni 12**

#### **Administratori**

1. Administrator i shoqërisë është Znj. Lorena RRAPAJ dhe afati i emërimit është për një periudhë 5 vjeçare nga dita e regjistrimit, me të drejtë ripërsëritjeje.
2. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë në çdo kohë administratorin, me shumicë të zakonshme. Asnjë marrëveshje tjetër nuk mund të përjashtojë apo kufizojë këtë të drejtë.
3. Administratori mund të heqë dorë në cdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme.

### **KAPITULLI IV**

### **SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

#### **Neni 13**

#### **Shpërndarja e shoqërisë**

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar shpërndahet:
  - a) kur mbaron kohëzgjatja për të cilën është themeluar;
  - b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
  - c) në rast se objekti bëhet i perealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë



- absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;  
ç) për cdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e përgjithshme e ortakëve;  
d) në raste të tjera të parashikuara në ligj;

#### **Neni 14 Likuidimi**

1. Me përjashtim të rasteve kur ka nisur një procedurë falimentimi, mbyllja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas parashikimeve të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar.

#### **Neni 15 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij akti të themelimit e statuti, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
2. Në rast se mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim, atëherë kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

#### **Neni 16 Dispozita të përgjithshme**

1. Ky Akt themelimi dhe Statut i shoqërisë “**PRO BONO**” SHPK, u hartua dhe redaktua, me vullnet të lirë e të plotë të Ortakut të Vetëm Themelues, në 2 kopje me vlerë të njëjtë juridike, në gjuhën shqipe.
2. Ortaku i vetëm themelues autorizon Administratorin Znj. Lorena RRAPAJ, me dokument identifikimi ID nr. 032818345, të depozitojë këtë Akt Themelimi dhe Statut të shoqërisë “**PRO BONO**” SHPK, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për regjistrimin e saj si person juridik.

#### **ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË**

**Znj. Lorena RRAPAJ**

